

VENDIM
Nr. 3152/4, datë 12.12.2018

PËR REZULTATIN E ZGJEDHJEVE
DHE SHPALLJEN E FITUESVE

Në mbështetje të nenit 115 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni i Votimit me përbërje:

Arqilea Koça, kryetar;

Adnand Kosova, anëtar;

Alfred Progonati, anëtar,

pasi administroi gjithë dokumentacionin e votimit, numëroi votat, përpiloi procesverbalin përkatës,

VËREN:

Në përfundim të procesit të votimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kandidatët për çdo shkallë sipas numrit më të madh të votave, renditen në mënyrën si vijon:

Kandidatët nga prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë:

Z. Gentjan Osmani 181 vota;

Znj. Antoneta Sevdari 161 vota;

Z. Besnik Cani 148 vota;

Z. Dritan Prençi 127 vota;

Z. Vatë Staka 86 vota;

Z. Besnik Muçi 75 vota.

Kandidatët nga prokurorët pranë gjykatave të apelit:

Z. Bujar Sheshi 246 vota;

Z. Arben Dollapaj 232 vota.

Kandidatët nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme:

Z. Kostaq Beluri 202 vota;

Znj. Anila Leka 86 vota.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenin 115, paragrafët 5 e 7, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenit 15 të Rregullores së Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve, Komisioni i Votimit

VENDOSI:

1. Të shpallë fitues prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë:

Z. Gentjan Osmani;

Znj. Antoneta Sevdari;

Z. Besnik Cani.

2. Të shpallë fitues prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit:

Z. Bujar Sheshi;

Z. Arben Dollapaj.

3. Të shpallë fitues prokurorin e Prokurorisë së Përgjithshme:

Z. Kostaq Beluri.

4. Ky vendim të shpallet zyrtarisht në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme jo më vonë se 24 orë nga Mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme.

KOMISIONI I VOTIMIT
Adnand Kosova, Arqilea Koça,
Alfred Progonati